



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Tetë organizata përkrahen nga fondi i Grave të Kosovës

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka përkrahur tetë organizatave anëtare nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës nga gjithsejt 29 aplikacione. Përzgjedhja e përfutueseve u bë nga Komiteti Shqyrtues i Granteve të Fondit të Grave të Kosovës, i përzgjedhur nga anëtarët e RrGGK-së vitin e kaluar. Organizatat të cilat ishin përfutuese të grantit janë:

1. Shoqata e të Shurdhërve në Prizren, e cila do të organizojë vizita sistematike gjinekologjike dhe trajnime shëndetësore për femrat e shurdhëra.

2. Qendra e Gruas "Prehja" do të organizojë trajnime, takime dhe diskutime publike për gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit në Skënderaj.

3. Qendra për Zhvillimin Ekonomik të Grave në Shtërpce "Ikebana" do të përfshijë gratë në procesimin dhe prodhimin e bimëve mjekuese.

4. Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim do të përpikët që të fuqizojë ekonomikisht gratë në Komunën e Novobërdes duke ndërtuar aftësitë e tyre të biznesit dhe duke iu siguruar paisje për tharjen dhe përpunimin e frutave, pjekurinave dhe ëmbëlsirave.

5. Gruaja Hyjnore do të fuqizojë gratë në Gjilan përmes punëtorive mbi barazinë gjinore, të drejtave të grave në trashëgiminë e pronës dhe teknikave të avancuara në artin e punëdores artizanale.

6. Parajsa Jonë do të trajnojë gratë në zonat rurale të Komunës së Lipjanit në hortikulturë dhe ndërmarrësi.

7. Shoqata e Grave Femere "Krusha e Vogël" do të fuqizojë ekonomikisht gratë në zonat rurale në fshatrat e Krushës së Vogël dhe Hasit përmes seminarëve në menaxhimin e biznesit, marketingut dhe higjienës së qumështit duke përfshirë edhe ndarjen e përvojave me fermerët e OJQ-ve të tjera.

8. Lulebora do të ofrojë këshillime dhe do të mbështesë vizitat gjinekologjike për gratë dhe vajzat që jetojnë në lagjet Rome në Mitrovicë.

Raundi i dytë i granteve ka pranuar fonde nga Austrian Development Agency (ADA) dhe mbështetje shtesë nga Kvinna till Kvinna (KtK).

"Isha shumë e lumtur të kuptojë që OJQ-ja jonë është shpërblyer me një grant. Ky grant do të thotë mbështetje për gratë që gjithmonë kanë qenë të lëna anash."

**- Krenare Hajredini,
Shoqata e Personave të Shurdhër**

Bashkangjituni me ne!

Takimi i Rregullt i RrGGK më 3 Qershor 2013

Festivali i Artit, i organizuar nga OJQ Artpolis, 27-30 Maj 2013 në Teatrin Oda

Në këtë numër

Gratë Krijojnë Strategji për Zgjedhjet Komunale.....2

Gratë Ndërmarrëse Krijojnë Platformë.....2

Programi për Zhvillim Rural Mbështetë Gratë.....3

Anëtarët e RrGGK Mbajnë Takim në Gjakovë.....4



**Faqja në Facebook
Grupi në Facebook**



Lista e dërgesave të E-lajmeve



Tetë anëtare të RrGGK pranojnë grante nga Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK-së në Prill.

Gratë Krijojnë Strategji për Zgjedhjet Komunale

RrGGK organizoi një diskutim më 29 mars, gjatë të cilit 27 gra nga shtatë asamble komunale dhe organizatat anëtare të RrGGK-së krijuan strategji për pjesëmarrje më të madhe të grave në zgjedhjet e ardhshme komunale. Vjosa Dobruna, Aktiviste e të Drejtave të Njeriut dhe anëtare e Bordit Këshillues të RrGGK-së e udhëhoqi diskutimin. Pjesëmarrëset kërkuan të gjenerojnë ide për rritjen e numrit të grave në asambletë komunale dhe në pozita udhëheqëse në nivelin komunal.



Vjosa Dobruna, Aktiviste e të Drejtave të Njeriut dhe anëtare e Bordit Këshillues të RrGGK diskuton strategji për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

“Ky takim hapi diskutime për fuqizimin e grave, një obligim dhe mandat për RrGGK,” tha Vjosa Dobruna.

Takimi poashtu shërbeu për të inkurajuar më shumë gra që të kandidojnë për kryetare komune. Pjesëmarrëset diskutuan se cilat kualitete duhet t'i kenë gratë kandidatë: ato duhet të jenë feministe, të kenë një qasje të ndryshme nga meshkujt, të jenë aktive në shoqëri dhe të kenë dëshirën politike për të promovuar barazinë gjinore.

“E çmoj këtë nismë të guximshme dhe mendoj se ne të gjitha mund të kontribuojmë vazhdimisht në këtë fushë,” tha Violeta Dema, përfaqësuese nga Asambleja Komunale e Gjakovës.

Diskutimi poashtu inkurajoi bashkëpunimin në mes të grave të ndryshme dhe theksoi rolin e rëndësishëm që mund të luajë shoqëria civile.

“Ky takim na ofroi mundësinë që të flasim për atë se çka mund të bëjmë ne si shoqëri civile që të ndihmojmë,” tha Drita Vukshinaj nga OJQ Gratë për Gratë me Aftësi të Kufizuara në Prizren.

Disa konkluzione që rezultuan nga takimi përfshinin:

- Të punohet me gratë kandidatë dhe partitë politike në mënyrë që partitë që fitojnë ulëset në asambletë komunale të sigurojnë që gratë të marrin pozita vendim-marrëse.
- Të krijohet një mjedis mundësishë që më shumë gra të hyjnë në politikë duke shkuar derë-më-derë për të avokuar që qytetarët të votojnë për gratë kandidatë.
- Të inkurajohen partitë politike që të nominojnë unanimisht një grua kandidatë për pozitën e kryetares së komunës në zgjedhjet e ardhshme dhe të krijohet një mjedis i përshtatshëm për fushatën e saj.
- Të organizohen fushata mediale që të paraqesin me saktësi platformat e fushatave të grave.
- Të krijohet një sektor i ri në uebfaqen e RrGGK-së dhe/ose një forum në Facebook ku gratë mund të ndajnë idetë dhe të diskutojnë strategjitë për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në qeverisjen lokale.
- Të inkurajohet përfshirja e vazhdueshme e grave në asambletë komunale edhe pas pensionimit në mënyrë që ato të mund të ndajnë përvojën dhe njohuritë e tyre.

“Grate kishin frikë për shkak të përvojave të tyre të mëparshme sepse u mungonte mbështetja” konkludoi Vjosa Dobruna. “Por prej frikës së tyre dhe pengesave të mëparshme ne do të mësojmë dhe do të dijmë më mirë se si t'i adresojmë këto çështje në të ardhmen.”

Gratë Ndërmarrëse Krijojnë Platformë

Më 8 Prill, 40 subjekte nënshkruan *“Platformën Kombëtare të Grave Ndërmarrëse në Republikën e Kosovës”*. Nënshkruesit përfshinin OJQ, shoqata të grave, shoqata të biznesit, rrjete, institucione të edukimit dhe trajnimit dhe media.

Nënshkrimi pasoi një punëtori paraprake në të cilën ata zhvilluan platformën, të mbajtur më 22 Mars. Strategjitë kryesore për rritje ekonomike të identifikuara në Platformë përfshijnë partneritetet publiko-private, barazinë gjinore dhe krijimin e rrjeteve të ndërmarrësve dhe shoqatave të biznesit. Një grup vullnetarë, jo formal që punon për zhvillimin dhe promovimin e grave ndërmarrëse në Kosovë, si dhe eliminimin e çdo lloj diskriminimi gjinorë udhëheq implementimin e Platformës.

“Kjo është hera e parë që një Platformë e tillë është krijuar në Kosovë,” tha një përfaqësuese nga Shoqata

Vazhdon në fq. 3.

Afariste e Gruas SHE-ERA. “E tëra është e bazuar direkt në nevojat e grave ndërmarrëse dhe konform ligjeve dhe rregullave të BE-së.”

Platforma është krijuar në bazë të [Aktit të Biznesit të Vogël për Evropë](#) (i nxjerrë nga Treguesit e Grave Ndërmarrëse të Stambollit), [Parimeve të Prishtinës](#) (sektori i Fuqizimit Ekonomik të Grave, nga Samiti Presidencial i Republikës së Kosovës), [Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme \(2012-2020\)](#), [Ligjit për Barazi Gjinore](#), [Programit të Kosovës për Barazi Gjinore](#), [Planit të Veprimit të Kosovës për Fuqizimin Ekonomik të Grave 2011-2013](#), si dhe [Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Llojeve të Diskriminimit ndaj Grave \(KEDNG\)](#).

Platforma synon të promovojë gratë ndërmarrëse në Republikën e Kosovës përmes partneriteteve publike dhe private. Ajo kërkon që të ndihmojë gratë të kapërcejnë pengesat për ndërmarrësi dhe të eliminojë të gjitha format e diskriminimit gjinorë.

Kjo iniciativë po ndërmirret nga nëntë vende të BE-së para-pranimit në Evropën Juglindore. Ajo është mbështetur nga Mbretëria e Suedisë dhe e implementuar nga Qendra Juglindore Evropiane për Mësimë Ndërmarrësie (QJLEMN), Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (KRB) dhe Task Forca Gjinore (TFGj) për Evropën Juglindore. Partnerët që po implementojnë projektin në Kosovë janë Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA dhe Rrjeti “Qeliza”.

Programi për Zhvillim Rural Mbështetë Gratë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) planifikon të ofrojë asistencë financiare për gratë ndërmarrëse që punojnë në sektorë të ndryshëm bujqësorë. Programi për Zhvillim Rural i saj do të ofrojë asistencë sociale që kap shumën rreth 27 milion Euro në vitin 2013. Përmes kësaj mbështetjeje financiare, MBPZHR synon të përmirësojë infrastrukturën e fermave, të rrisë produktivitetin, të përmirësojë kualitetin e produkteve bujqësore, të rrisë konkurrencën në mes të prodhuesve vendorë, të rrisë punësimin dhe të ardhurat në mes të fermerëve dhe popullatës rurale dhe të shtyjë më tutje përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Të gjithë fermerët kosovarë në sektorë bujqësorë të ndryshëm mund të përfitojnë nga ky program dhe gratë do të jenë prioritet për mbështetje.

MBPZHR ka ndarë 12 milion Euro për subvencione në grurë, misër, luledielli, dhi, lopë dhe buallica qumështore. 15 milion Euro të tjera janë ndarë për grante investimesh për prodhime të qumështit, mishit, vezëve, mjaltës, perimeve, pemëve, vreshtarisë dhe bimëve mjekësore,

Më 1 Mars, organizata anëtare e RrGGK-së, Shoqata Afariste “SHE-ERA” u takua me Departamentin e Bujqësisë në Gjakovë që të informojë zyrtarët për punën e grave ndërmarrëse. Përfaqësuesit e SHE-ERA prezantuan biznes planet e përgatitura nga gratë e Gjakovës dhe kërkesat e grave për bashkë financim. Iniciativat e grave kanë pranuar mbështetje nga projekti “Mbështetje për Gratë Ndërmarrëse në Bujqësi 2012-2015”, i financuar nga Ministria për Punë të Jashtme e Danimarkës. Projekti po implementohet në katër regjione të Kosovës: Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Pejë.

“Pasi që gratë e zonave rurale janë gjithmonë të fundit që marrin informata për skemat e granteve qeveritare, SHE-ERA kërkoi që zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë të takohen me gratë sipërmarrëse, si përfutuese të projektit, që t’i informojnë ato për mundësitë për grante dhe subvencione që ofrohen nga Ministria,” tha një përfaqësuese e SHE-ERA.

Gjatë takimit të lartpërmendur, gratë pranuan informata për subvencione dhe asistencë financiare që ofrohet nga MBPZHR për fermerët kosovarë dhe kriteret që gratë duhet të përmbushin për të aplikuar.

Pasi që raundi i parë i granteve të MBPZHR është mbyllur, anëtarët e RrGGK të interesuara për të aplikuar duhet të përcjellin mediat dhe uebfaqen e MBPZHR për Thirrje të Ardhsme për Aplikim. Gratë poashtu mund të vizitojnë Departamentet e Bujqësisë në komunat e tyre për informata të mëtutjeshme lidhur me kriteret e aplikimit. Stafi i SHE-ERA mund t’i ndihmojë gratë ndërmarrëse në bujqësi në përmbushjen e kriterëve të aplikimit. Për ndihmë, ju lutem kontaktoni wsheera@gmail.com.

MBPZHR poashtu planifikon të mbështesë fermerët në mekanizmin bujqësorë. Ata poashtu kanë lajmëruar mbështetje për investime në zonat rurale më pak të zhvilluara, ujitje të tokave bujqësore, paisje për agropërpunim, deponim, marketing dhe projektet publiko-private të identifikuar nga [Grupet Lokale të Veprimit](#).



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të ofrojë rreth 27 milion Euro ndihmë financiare në vitin 2013, duke i dhënë prioritet ndihmës për gratë fermere.

Anëtarët e RrGGK Mbajnë Takim në Gjakovë

Rreth 60 persona morrën pjesë në Takimin e Rregullt të RrGGK-së më 8 Prill 2013 në Gjakovë. Pjesëmarrësit përfshinin organizatat anëtare të RrGGK, anëtare të bordit dhe persona të tjerë të interesuar.

Besa Shehu, Menaxhere e Financave dhe Administratës në RrGGK, hapi takimin, duke shpallur emrat e tetë organizatave të shpërblyera me grante përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK). Ajo poashtu inkurajoi organizatat që nuk kanë përfitur grante që të aplikojnë prapë. Raundi tjetër so të hapet më 15 Maj 2013.

“OJQ-të do të marrin ndihmë dhe mbështetje nga stafi i RrGGK me qëllim që të përmirësojnë aplikacionet e tyre,” tha ajo. RrGGK vazhdon të organizojë mundësi për ndërtimin e kapaciteteve për anëtarët e saj, në mënyrë që ato të mund të përfitojnë jo vetëm nga Fondi i Grave të Kosovës, por edhe nga fonde të tjera.

Zana Rudi, Koordinatore e Projektit për Anëtarët e RrGGK, prezantoi *Raportin e Monitorimit të Kodit të Mirësjelljes të RrGGK dhe Planin e Ngritjes së Kapaciteteve për Anëtarët* për vitin 2013. Raporti rezultoi nga intervistat me 82 nga 100 organizatat anëtare të RrGGK-së. Raporti prezanton pikat e forta të anëtareve dhe fushat ku anëtarët kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve. Bazuar në gjetjet, RrGGK planifikon të organizojë 12 trajnime gjatë vitit 2013; dy janë mbajtur deri më tash. Pasi që buxheti i RrGGK është i limituar, stafi dhe mbështetësit e RrGGK-së kanë dhuruar vullnetarisht kohën e tyre për të ofruar trajnime për anëtarët. RrGGK poashtu po përgatitë një raport individual për secilën anëtare, duke vënë në pah pikat e tyre të forta dhe fushat ku ato do të mund të zhvillojnë më tutje kapacitetet e tyre.

Pastaj, Mirlinda Kusari-Purrini, Drejtoreshë Ekzekutive e organizatës anëtare të RrGGK-së SHE-ERA, informoi pjesëmarrësit për *"Platformën Kombëtare të Grave Ndërmarrëse në Republikën e Kosovës"*.

“Draft platforma është e mbështetur nga Atifete Jahjaga, Presidente e Kosovës, e cila është e gatshme që ta shtyejë atë përpara dhe grupi i grave parlamentare në Parlamentin e Kosovës,” tha ajo. “Një organizatë jo formale do të avokojë për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe mbështetjen e grave ndërmarrëse.”

Ajo poashtu informoi pjesëmarrësit për planet e *Ministritë së Tregtisë dhe Industrisë* për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe *Programin për Zhvillim Rural të Ministritë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*. Këto janë dy mënyra se si anëtarët e RrGGK-së mund të përfitojnë fonde drejt fuqizimit ekonomik të grave.

Emine Berisha, hulumtuese e RrGGK dhe Alter Habitus, ofroi informata për hulumtin e përbashkët të dy organizatave “Ku janë Paratë për të Drejtat e Grave: një Rast Studimi për Kosovë”, mbështetur nga Association for Women’s Rights in Development (AWID). Kjo iniciativë hulumtimi do të ndihmojë në identifikimin e trendeve të fondeve që lidhen me mbështetjen e organizatave të grave dhe të drejtave të grave gjatë dekadës së fundit në Kosovë. Eminja është duke intervistuar anëtarët e RrGGK-së dhe të gjitha informatat e ofruara nga anëtarët do të mbesin konfidenciale.

Anëtarët e RrGGK-së pastaj ndanë informatat në vazhdim:

- Dardana Mehmeti nga OJQ Artpolis ofroi informatën për një festival që do të mbahet më 27-30 Maj në Teatrin Oda, ku gratë artiste do të prezantojnë punën e tyre. Festivali do të fokusohet në aspektet sociale të jetës, veçanërisht të drejtat e grave dhe vajzave dhe në sfidat me të cilat ato përballen në Kosovë dhe në regjion.
- Veprorë Shehu nga OJQ Medica Kosova tha se 20 gra dhe gjashtë anëtare të stafit do të vizitojnë Stambollin me mbështetje nga Ambasada Turke.

Në fund, Nertila Qarri, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun në RrGGK, theksoi se anëtarët e RrGGK-së mund të dërgojnë informata për aktivitetet e tyre në info@womensnetwork.org për përfshirje në buletinin mujor të RrGGK-së *Zëri i Grave Kosovare*.

Takimi i ardhshëm i anëtareve të RrGGK-së do të mbahet më 3 Qershor 2013.



Gjatë takimit të rregullt të RrGGK-së në Gjakovë, Mirlinda Kusari-Purrini, Drejtoreshë Ekzekutive e SHE-ERA, informon anëtarët e RrGGK për mundësi të reja nga Qeveria e Kosovës drejtë fuqizimit ekonomik të grave.